EKOSISTEMI MEDIATIK DHE ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet në Maqedoninë e Veriut

Dokument për politika publike



DOI: 10.64370/ETZL4884

Институт за комуникациски студии

respublica

Botues:
Instituti për Studime të Komunikimit
Rr. "Jurij Gagarin" 17-1 / 1, Shkup
www.iks.edu.mk

Rreth botuesit:
prof. dr. Zaneta Trajkoska

Edicioni:
ResPublica

Autorë:
prof. dr. Marina Tuneva
dr. Dragan Sekullovski

Redaktorë:
mr. Dejan Andonov
Aleksandra Temenugova

Përkthim nga maqedonisht në shqip:
Vjosa Taipi

Titulli origjinal:
Медиумскиот екосистем и странското мешање и манипулирање со информации во Северна Македонија - документ за јавна политика

Dizajni grafik:
Zoran Kardula

Redaktimi grafik:
Dejan Joveski

Vendi dhe viti:
Shkup, 2026

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

327.8:07(497.7)(047.31)

TUNEVA, Marina
Ekosistemi mediatik dhe ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionetnë Maqedoninë e Veriut [Електронски извор] : dokument për politika publike / [autorë Marina Tuneva, Dragan Sekullovski ; përkthim nga maqedonisht në shqip Vjosa Taipi]. - Shkup : Instituti për Studime të Komunikimit, 2026. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување
(URL): http://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2026/01/ekosistemi-mediatik-dokument-per-politika-publike-al.pdf.
- Превод на делото: Медиумскиот екосистем и странското мешање и манипулирање со информации во Северна Македонија : документ за јавна политика. - Текст во PDF формат, содржи 50 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 29.01.2026. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 47-50

ISBN 978-608-4805-78-6

1. Sekullovski, Dragan [автор]
а) Медиуми -- Странски влијанија -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 67994373

PËRMBAJTJA

REZYME **5**
HYRJE **8**
Metodologjia **11**
1. KONTEKSTI DHE PROBLEMI: NHMI SI SFIDË PËR INTEGRITETIN MEDIATIK DHE PROCESET DEMOKRATIKE **12**
1.1. Matrica e ekspozimit të NHMI-së: korniza për hartëzimin e kanaleve 15

2. KONTEKSTI EVROPIAN RREGULLATOR DHE STRATEGJIK PËR NHMI-në NË MEDIA DHE EKOSISTEMIN DIGJITAL **17**
2.1. Instrumentet rregullatore: llogaridhënia e platformës, transparenca dhe mbrojtja e pluralizmit mediatik 18
2.2. Këshilli i Evropës dhe perspektiva e sigurisë: të drejtat e njeriut, dizajni dhe qëndrueshmëria 19
2.3. Implikimet për Maqedoninë e Veriut: detyrimet dhe mundësitë në kontekstin e integrimit në BE 20

3. PERCEPTIMET DHE NEVOJAT QË LIDHEN ME NHMI-në NË EKOSISTEMIN MEDIATIK NË KONTEKSTIN KOMBËTAR **21**
3.1. Legjislacioni për mediat dhe zgjedhjet: bazë normative, pa qasje të integruar për NHMI 24
3.2. Rregullimi digjital dhe mjedisi online: fushëveprimi i kufizuar rregullator jashtë mediave tradicionale 24
3.3. Siguria kombëtare dhe kërcënimet hibride: Njohja e rrezikut pa operacionalizimin e medias 25
3.4. Siguria kibernetike dhe legjislacioni: një bazë e fortë për menaxhimin e incidenteve, por jo një zëvendësim për qasjen në NHMI 26
3.5. Arsimi dhe edukimi mediatik: parandalimi dhe qëndrueshmëria afatgjatë 27
3.6. Sinteza: çfarë mungon në sistem dhe pse është e rëndësishme 28

4. ZBATIMI I MATRICES SË EKSPOZIMIT TË NHMI NË KONTEKSTIN E MAQEDONISË SË VERIUT **30**
4.1. Si dhe pse e përdorim matricën? 31
4.2. Çfarë do të thotë kjo në praktikë: skenarë të përsëritur që lidhen me Maqedoninë e Veriut 33

5. MEKANIZMAT EKZISTUES DHE BOSHLLËQET NË PËRGJIGJEN E SHTETIT DHE SEKTORIT MEDIATIK 34
5.1. Mekanizmat shtetërorë: ekzistojnë elementë të rëndësishëm, por mungon një kornizë e unifikuar 35
5.2. Vetë-rregullimi dhe praktikat mediatike: bazë e fortë, por me kufizime në hapësirën online.....36
5.3. Roli i shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë: kapaciteti bartës, por pa një platformë të përhershme koordinimi 37
5.4. Boshllëqet kryesore përmes prizmit të Matricës së ekspozimit ndaj NHMI-së 37

6. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME PËR POLITIKAT PUBLIKE.....39
6.1. Përfundim..... 40
6.2. Masat e propozuara për politika publike..... 41

REZYME

Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit (NHMI) përbën një rrezik kompleks sistematik për shoqëritë demokratike që po shfaqet dhe po amplifikohet përmes mediave. NHMI-ja vepron përmes aktiviteteve të koordinuara të aktorëve të huaj shtetërorë dhe joshtetërorë, ndërmjetësve të tyre dhe kanaleve të harmonizuara, të cilat, ndër të tjera, shfrytëzojnë cenueshmërinë ekonomike, institucionale dhe digjitale të mediave për të ndikuar në debatin publik, besimin në institucione dhe proceset demokratike.

Ky dokument për politika publike analizon një fenomen të tillë në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, me fokus në ekosistemin mediatik, kornizën rregullatore dhe mekanizmat institucionalë, dhe propozon masa për të zvogëluar rreziqet me respekt të plotë për lirinë e shprehjes dhe në përputhje me kornizat rregullatore evropiane. Në vend të atribuimit të operacioneve konkrete, dokumenti zbaton një kornizë analitike -Matricën Evropiane të Ekspozimit NHMI(FIMI Exposure Matrix), për njohjen e teknikave, kanaleve dhe aktorëve që lejojnë manipulimin dhe përzierjen.

Analiza tregon se **NHMI në kontekstin kombëtar nuk rregullohet si një fushë e veçantë dhe e integruar**, ndërsa aspektet përkatëse të saj janë të ndara në të gjithë legjislacionin mediatik dhe zgjedhor, rregullimin digjital, kornizat kibernetike dhe të sigurisë kombëtare, si dhe politikat arsimore. Kjo qasje e fragmentuar lejon **zbulimin e pjesshëm, por jo menaxhimin sistematik të rrezikut**. Media dhe rregullimi zgjedhor ofrojnë garanci të rëndësishme demokratike, por mbeten kryesisht reaktive dhe të orientuara drejt përmbajtjes. Rregullimi digjital dhe legjislacioni kibernetik krijojnë një bazë solide për menaxhimin e rreziqeve dhe incidenteve teknike, por nuk e trajtojnë NHMI-në si një problem mediatik.

Gjetjet sugjerojnë **faktorë sistemikë që rrisin ekspozimin e hapësirës mediatike ndaj ndikimit manipulues.** Sulmet fizike dhe online, kërcënimet ligjore dhe mungesa e mbrojtjes së mjaftueshme institucionale e zvogëlojnë kapacitetin për hulumtim, verifikim dhe raportim kritik, të cilat janë thelbësore për identifikimin dhe demaskimin e ndikimeve të koordinuara informative. Tregu i kufizuar mediatik, presionet financiare dhe transparenca e pamjaftueshme e rrisin cenueshmërinë e një pjese të mediave ndaj presioneve dhe ndikimeve, si dhe e ngushtojnë autonominë redaktuese. Në platformat digjitale, algoritmet shpesh shpërblejnë përmbajtje që nxit reagime të forta, duke u dhënë mesazheve manipuluese një shtrirje më të madhe, ndërsa burimeve të verifikuara më pak dukshmëri. NHMI, nga ana tjetër, rrallëherë shfaqet si një teknikë e vetme dhe më së shpeshti manifestohet përmes kombinimeve të paraqitjes selektive të fakteve, dezinformatave, amplifikimit të koordinuar, narrativave manipuluese dhe keqpërdorimit të influencuesve dhe faqeve pseudo-mediale. Rreziqet rriten gjatë cikleve zgjedhore, krizave të sigurisë dhe gjeopolitike, si dhe në raste me interes të lartë publik, kur presioni për informacion të shpejtë përshpejton përhapjen e përmbajtjeve të paverifikuara.

Në të njëjtën kohë, vërehen **boshllëqe në koordinim, përkatësisht protokolle jo mjaftueshëm të qarta për reagim të shpejtë dhe shkëmbim të informacionit** midis institucioneve, rregullatorëve, mediave dhe shoqërisë civile, dhe **mungesë të mbështetjes sistematike për edukimin mediatik dhe informativ** si një shtyllë afatgjatë dhe parandaluese e rezistencës.

Në bazë të analizës, rekomandimet e këtij dokumenti për politika publike kanë

për qëllim masat që mund të zbatohen paralelisht, me prioritet të qartë transparencën, komunikimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve profesionale dhe publike. Kjo nënkupton:

- forcimin e **transparencës së financimit dhe pronësisë së** medias dhe vizibilitetit publik të reklamave politike/të paguara në internet;
- përcaktimin e **protokolleve për komunikim të shpejtë, të saktë dhe të qëndrueshëm në situata krize** me role dhe përgjegjësi të caktuara qartë, pa ndërhyrë në autonominë editoriale;
- **trajnime të vazhdueshme në redaksive** për verifikimin, sigurinë digjitale, standardet editoriale dhe punën me burim të hapur (OSINT), me fokus të veçantë në nivel lokal;
- **bashkëpunimi me platformat** përmes transparencës së moderimit, qasjes në të dhëna për qëllime kërkimore dhe interes publik, si dhe dukshmërisë më të mirë të burimeve kredibile, pa censurë dhe me respektim të lirisë së shprehjes;
- forcimin e rezistencës së publikut përmes **programeve të edukimit mediatik dhe informativ** dhe promovimin e kontrollit të fakteve; dhe
- vendosjen e **koordinimit ndër-sektorial** midis institucioneve, organizatave të medias, sektorit civil dhe komunitetit akademik për monitorimin e tendencave, paralajmërimin e hershëm dhe vlerësimin e efekteve të masave.

Këto masa do të sigurojnë forcimin e qëndrueshmërisë së medias dhe ekosistemit digjital dhe do të mbrojnë lirinë e shprehjes dhe interesin publik në kushtet e ndikimeve të huaja të informacionit.

HYRJE

Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacione (NHMI)*(Foreign Information Manipulation and Interference - FIMI)*, është një kërcënim kompleks dhe afatgjatë për shoqëritë demokratike, i cili manifestohet gjithnjë e më shumë përmes sistemeve të medias dhe komunikimit publik. Ndryshe nga format klasike të propagandës ose rastet e veçuara të dezinformatave, NHMI përfshin aktivitete të koordinuara dhe të qëllimshme të aktorëve të huaj shtetërorë dhe joshtetërorë (përfshirë edhe ndërmjetësit e tyre), të orientuara drejt minimit të besimit në media, institucione dhe procese demokratike, përmes keqpërdorimit sistematik të mediave tradicionale dhe kanaleve digjitale (EEAS, 2023).

Qasjet moderne evropiane ndaj NHMI-së, të zhvilluara nga Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm *(European External Action Service - EEAS)*, tregojnë se NHMI-ja është, mbi të gjitha, një problem strukturor (EEAS, 2023). Në vend që të përqendrohen vetëm në përcaktimin e „informacioneve të pasakta", këto qasje analizojnë infrastrukturën e ndikimit, përkatësisht rrjetet e kanaleve zyrtare, mediat e kontrolluara nga shteti, aktorët formalisht të pavarur, por në praktikë të koordinuar, si dhe ekosistemet më të gjera të kanaleve që mbështesin njëri-tjetrin dhe krijojnë së bashku një efekt manipulativ mbi hapësirën publike (EEAS, 2025).

Në këtë kontekst, mediat nuk janë vetëm "viktima" ose "ndërmjetës" të ndikimit të huaj, por pjesë e sistemit në të cilin operacionet e NHMI-së mund të nguliten, riprodhohen ose sfidohen. Cenueshmëria ekonomike e tregut mediatik, transparenca e pamjaftueshme e strukturave të pronësisë dhe të ardhurat financiare, varësia nga platformat online dhe shpërndarja e përmbajtjeve e menaxhuar nga algoritmet krijojnë një mjedis ku ndikimet manipulative mund të shfaqen edhe pa bashkëpunim të drejtpërdrejtë ose të vetëdijshëm të aktorëve mediatikë. Këto dobësi strukturore gjithashtu vërehen vazhdimisht në vlerësimet e qëndrueshmërisë së sektorit të mediave në Maqedoninë e Veriut, ku kufizimet financiare dhe burimet e pamjaftueshme shoqërohen me cilësi të zvogëluar të informacionit dhe ndjeshmëri më të madhe ndaj presioneve (IREX, 2024). Prandaj, NHMI është një sfidë jo vetëm për profesionin e gazetarisë, por edhe për rregullimin e medias, vetë-rregullimin dhe koordinimin institucional.

Republika e Maqedonisë së Veriut, si një vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përballet me këto rreziqe në kushte të dobësive strukturore shtesë. Polarizimi politik, besimi i kufizuar në institucione, presionet ekonomike mbi mediat dhe niveli relativisht i ulët i arsimimit mediatik dhe digjital rrisin ekspozimin e ekosistemit mediatik ndaj ndikimeve të huaja manipuluese, veçanërisht gjatë periudhave të ndjeshmërisë politike, zgjedhjeve ose krizave, dhe e bëjnë reagimin sistematik më të vështirë (SHGM, 2024). Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2025 (European Commission, 2025) vëren se kuadri ligjor për mediat nuk është ende plotësisht në përputhje me acquis, duke përfshirë rregulloren e re evropiane, siç është Ligji Evropian për Lirinë e Mediave *(European Media Freedom Act – (EMFA)* (European Commission, 2024). Më tej, në të njëjtin raport thuhet se mbeten sfida lidhur me transparencën e pronësisë dhe se korniza për reklamimin shtetëror sjell rreziqe për keqpërdorime dhe cenim të tregut.

Në të njëjtën kohë, përgjigja e NHMI-së nuk duhet të bazohet në masa kufizuese ose kufizime ad-hoc të përmbajtjeve, pasi kjo paraqet një rrezik serioz për lirinë

e shprehjes dhe pluralizmin mediatik. Mjetet rregullatore evropiane, veçanërisht Ligji për shërbime digjitale *(Digital Service Act - DSA)* (European Union, 2022) dhe Ligji për lirinë e mediave *(EMFA)* theksojnë nevojën për menaxhim të rreziqeve sistemike, transparencë më të madhe, përgjegjësi dhe llogaridhënie, por pa ndërhyrë në autonominë redaktuese dhe diskursin legjitim publik.

Në këtë kuptim, **ky dokument i politikës publike ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e një qasjeje të orientuar drejt mediave dhe të harmonizuar rregullatorisht ndaj NHMI-së në Maqedoninë e Veriut. Fokusi është në rolin e ekosistemit të medias dhe palëve të interesuara përkatëse, si dhe kornizave rregullatore dhe institucionale që formësojnë veprimin e tyre, në mënyrë që të identifikohen boshllëqet kryesore dhe të ofrohen opsione të zbatueshme të politikave publike. Qëllimi përfundimtar është fuqizimi i qëndrueshmërisë së mediave dhe përmirësimi i koordinimit mes mediave, rregullatorëve, institucioneve dhe shoqërisë civile, në përputhje me standardet evropiane dhe parimet e lirisë së shprehjes dhe interesit publik.**

Dokumenti është përgatitur si një analizë e politikave, me qëllim që të kontribuojë në një kuptim më të mirë të NHMI-së si një rrezik sistematik dhe të identifikojë opsionet realiste të politikave publike për të forcuar qëndrueshmërinë e mediave dhe ekosistemit digjital. Është pjesë e punës së vazhdueshme hulumtuese dhe analitike të Institutit për Studime të Komunikimit (ISK) për ndërhyrjen e huaj dhe manipulimin me informacionet. Ky dokument lidhet me analizën fillestare për mënyrën se si NHMI manifestohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Haxhi-Janev dhe Stoilkovski, 2025), vazhdon perspektivën rregullatore dhe kontekstin evropian të zhvilluar në dokumentin e politikave publike (Blejer-Simon, 2025) dhe merr parasysh gjetjet dhe opsionet për përgjigje institucionale ndaj NHMI-së në vend (Grizhev dhe Poposka, 2025). Në këtë kuptim, dokumenti ruan përkufizimet dhe qasjen analitike tashmë të vendosura dhe i zhvillon më tej me fokus në ekosistemin mediatik: dobësitë e tij strukturore, kanalet dhe mekanizmat përmes të cilëve këto dobësi mund të shfrytëzohen, si dhe masat që janë proporcionale, transparente dhe të harmonizuara me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik.

Qasja është e harmonizuar me kornizat evropiane që analizojnë fenomene të tilla përmes modeleve të sjelljes, rrjeteve dhe kanaleve, dhe jo përmes përmbajtjeve të izoluara. Dokumenti nuk përcakton përgjegjësinë për operacione specifike dhe nuk "ia atribuon" operacionet aktorëve të veçantë, as nuk synon të prodhojë lista ose të "etiketojë" mediat, organizatat ose individët vendas. Në vend të kësaj, ai përqendrohet në dobësitë strukturore, boshllëqet institucionale dhe rregullatore dhe mënyrat e adresimit të tyre përmes masave që janë proporcionale dhe të mbrojtshme nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Parimet udhëheqëse janë: mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik; qasja e bazuar në rrezik me theks në transparencë dhe llogaridhënie; mbështetja e gazetarisë cilësore dhe autorregullimi si bazë për besimin publik; dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë shoqërore përmes edukimit mediatik dhe informativ dhe përmirësimit të koordinimit mes aktorëve relevantë.

Dokumenti fillon me një hyrje dhe sqarim metodologjik të NHMI-së dhe matricës analitike, pastaj e vendos problemin në kontekstin kombëtar dhe paraqet matricën e ekspozimit si një mjet për hartimin e kanaleve dhe efekteve. Më poshtë është një pasqyrë e kontekstit rregullator dhe strategjik evropian, dhe më pas një analizë e

perceptimeve dhe nevojave në vend dhe të segmenteve përkatëse normative dhe institucionale. Për më tepër, matrica zbatohet në kontekstin maqedonas për të identifikuar skenarët dhe dobësitë e përsëritura, pas së cilës merren parasysh mekanizmat ekzistues dhe boshllëqet kryesore. Dokumenti përfundon me konkluzione dhe projekt masa të politikave publike që synojnë institucionet, sektorin mediatik, organizatat e shoqërisë civile dhe platformat online, në frymën e proporcionalitetit, transparencës dhe mbrojtjes së lirisë së shprehjes.

Metodologjia

Ky dokument është përgatitur si një analizë e politikave publike, e bazuar në hulumtim desk dhe një sintetizë analitike të burimeve relevante evropiane dhe kombëtare, me qëllim të përshkruhet se si NHMI-ja manifestohet si një rrezik sistemik në ekosistemet mediatike dhe digjitale, si dhe të propozohen masa që fuqizojnë qëndrueshmërinë, pa kufizuar lirinë e shprehjes dhe pluralizmin mediatik.

Metodologjia mbështetet në:

(a) kornizat konceptuale dhe analitike evropiane për NHMI-në e Ligjit Evropian për lirinë e medias, duke përfshirë Matricën e Ekspozimit të NHMI-së ose *FIMI Exposure Matrix*) (EEAS, 2025) si një qasje për hartëzimin e kanaleve dhe modeleve të sjelljes,

(b) Instrumentet rregullatore evropiane që përcaktojnë detyrimet për menaxhimin sistematik të rrezikut, transparencën dhe mbrojtjen e lirisë së medias (Ligji për shërbime dixhitale *(DSA)*, Ligji për lirinë e mediave *(EMFA)*, Rregullorja për reklamim politik, Ligji për inteligjencën artificiale (AI Act) dhe mekanizmat përkatës (ko) rregullatorë),

(c) dokumentet kombëtare përkatëse ligjore dhe strategjike për mediat, mjedisin digjital dhe sigurinë, dhe

(d) analizat lokale dhe rajonale për sistemin mediatik, besimin, rreziqet informative dhe sigurinë e gazetarëve.

Zgjedhja e burimeve u udhëhoq sipas kritereve të rëndësishmërisë për qëllimet e dokumentit, autoritetit institucional dhe ekspertizës (me prioritet për BE-në dhe Këshillin e Evropës), verifikueshmërisë dhe zbatueshmërisë në kushtet e Maqedonisë.

Afati kohor i shqyrtimit është nëntor - dhjetor 2025. Dokumenti nuk përdor të dhëna të reja terreni (intervista, anketa ose grupe fokusi) dhe nuk përcakton origjinën/odgovjësinë për operacione ose aktorë të caktuar. Për shkak të dinamizmit të fenomenit, analiza synimisht fokusohet tek dobësitë strukturore, kapacitetet institucionale dhe politikat e qëndrueshme, në vend që të merret me raste të veçanta.

1.

Konteksti dhe problemi: nhmi si sfidë për integritetin mediatik dhe proceset demokratike

Në përkufizimin e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm *(EEAS)*, NHMI-ja përshkruhet kryesisht si një qasje "jo-ligjore" e sjelljes që mund të ndikojë negativisht në vlerat, procedurat dhe proceset politike dhe kryhet në mënyrë manipulative, me qëllim dhe në mënyrë të koordinuar, nga aktorë shtetërorë ose jo-shtetërorë, përfshirë ndërmjetësit (EEAS, 2023). NHMI nuk reduktohet në propagandë klasike ose raste të izoluara të dezinformatave. Bëhet fjalë për veprime të qëllimshme dhe të koordinuara, ku kanale të ndryshme komunikimi – nga mediat dhe rrjetet ndërmjetësuese deri te profile anonime në rrjetet sociale, influencuesit dhe faqet online të sinkronizuara – forcojnë njëri-tjetrin për të krijuar një pasqyrë të shtrembëruar të ngjarjeve, institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë (EEAS, 2025). Qëllimi kryesor shpesh është ulja e besimit dhe dobësimi i proceseve demokratike, dhe jo „bindja" e publikut për një tezë të vetme (EEAS, 2023).

Pasojat kanë karakter të dyfishtë - siguri dhe demokraci. Nga aspekti i sigurisë, ndikimet informative të huaja mund të ndikojnë në perceptimet publike dhe vendimet politike lidhur me politikën e jashtme, mbrojtjen ose orientimet kyçe gjeopolitike të shtetit. Nga aspekti demokratik, ato dëmtojnë pjesëmarrjen e informuar të qytetarëve në zgjedhje dhe debate publike, duke nxitur polarizim, cinizëm dhe apati (European Commission, 2024).

Në Maqedoninë e Veriut, këto rreziqe lidhen me dobësitë ekzistuese tashmë në ekosistemin mediatik dhe në besimin institucional. Komisioni Evropian, në raportet e tij për vendet kandidat, vëren një përparim të kufizuar në lirinë e shprehjes dhe thekson çështje të pazgjidhura, si transparenca e pronësisë dhe rreziqet e mundshme lidhur me reklamimin shtetëror (European Commission, 2025). Këto kushte krijojnë hapësirë që narrativat e jashtme të "lokalizohen" më lehtë përmes ndërmjetësve vendas, komuniteteve tematike ose targetimit të grupeve të cenueshme.

Për më tepër, transformimi digjital dhe varësia nga platformat e mëdha online nënkupton që një pjesë e madhe e komunikimit publik zhvillohet në mjedise të menaxhuara algoritmikisht dhe shpesh jo transparente, gjë që zvogëlon dukshmërinë e aktiviteteve manipulative të koordinuara dhe e vështirëson njohjen e hershme të rreziqeve (EEAS, 2025). Në këtë drejtim, Ligji për shërbime digjitale *(DSA)* përcakton detyrime, veçanërisht për platformat shumë të mëdha për të vlerësuar dhe zbutur rreziqet sistematike që lidhen me të drejtat themelore, debatin publik dhe proceset demokratike (European Commission, 2025).

Nga kjo perspektivë, NHMI është një rrezik jo vetëm për politikën e jashtme dhe të sigurisë, por edhe për vlerat themelore të rendit demokratik: pluralizmin, pjesëmarrjen e informuar, llogaridhënien e institucioneve dhe mediat e lira dhe të pavarura. Nevojiten politika që njohin karakterin sistemik të kërcënimit, fuqizojnë mediat dhe gazetarët si bartës të interesit publik dhe sigurojnë masa që janë proporcionale, transparente dhe të harmonizuara me standardet evropiane për lirinë e shprehjes.

Për qëllimet e këtij dokumenti, me NHMI kuptohet situata në të cilat, në mënyrë kumulative ose dominuese, identifikohen disa elementë të ndërlidhur.

- Së pari, ekziston një lidhje ose interes i huaj, përmes të cilit iniciohen, drejtohen ose kryhen aktivitete në interes të aktorëve të huaj shtetërorë ose joshtetërorë[1], shpesh përmes ndërmjetësve vendas dhe strukturave ndërmjetëse (EEAS, 2023).
- Së dyti, NHMI karakterizohet nga qëllimi në veprimet dhe koordinimi i tij, përkatësisht veprime të planifikuara dhe të harmonizuara përmes disa kanaleve dhe formateve, përfshirë rrjete të profileve dhe faqeve në rrjetet sociale, portale online dhe media, influencues, grupe dhe mjete të paguara komunikimi (EEAS, 2024).
- Së treti, brenda NHMI përdoren teknika manipulative të komunikimit, të tilla si mashtrimi, fshehja e burimit, prezantimi i rremë, kornizimi selektiv ose imponimi i narrativave përmes burimeve dhe platformave që duken të ligjshme (Council of Europe, 2021).
- NHMI ka një qëllim të qartë për ndikim mbi hapësirën publike, përfshirë proceset zgjedhore, politikat publike, besimin tek institucionet dhe mediat, kohezionin shoqëror dhe orientimet ndërkombëtare, me një efekt kumulativ mbi proceset demokratike (EEAS, 2023).

Në këtë qasje, dezinformimi është një element i rëndësishëm, por jo i vetmi. Ndikimi manipulativ mund të arrihet edhe përmes informacioneve të sakta të vendosura në një kontekst manipulativ, nëse ato amplifikohen në mënyrë të koordinuar dhe me një qëllim të qartë ndikimi (Council of Europe, 2021). Thelbësore është të kihet parasysh se një pjesë e madhe e përmbajtjeve që mund të konsiderohen të dëmshme (përfshirë dezinformatat) shpesh janë komunikim i ligjshëm dhe, si i tillë, përgjithësisht mbrohet nga liria e shprehjes dhe duhet të trajtohet ndryshe nga përmbajtja e paligjshme (Blejer-Simon, 2025). Specifika e NHMI-së qëndron në qëllimin, koordinimin dhe ndikimin potencial të dëmshëm të aktiviteteve të organizuara. Një efekt manipulues mund të arrihet gjithashtu me informacion të saktë, nëse vendoset në një kontekst manipulues dhe të amplifikohet në mënyrë të koordinuar përmes disa kanaleve.

Në kuptim praktik, NHMI-ja zakonisht identifikohet kur përputhen disa tregues: ekziston një interes i huaj; veprimet janë të koordinuara përmes disa kanaleve; përdoren teknika manipulative (për shembull, kontekstualizim i rremë, fshehja e burimit, imitimi i mediave të besueshme, keqpërdorimi i mekanizmave për amplifikim të shtrirjes); dhe ekziston një qëllim i qartë ndikimi mbi hapësirën publike në një shtet tjetër.

Për qëllime të analizës, është e dobishme të dallohen katër forma themelore:

(a) fushatat afatgjata që normalizohen gradualisht;

(b) operacionet rreth një ngjarjeje të caktuar (zgjedhje, kriza, protesta) me imponim të shpejtë të interpretimit;

[1] Aktorët jo-shtetërorë janë individë ose grupe me ndikim, si organizatat joqeveritare, korporatat ose grupet e armatosura, të cilët ndikojnë në proceset globale ose kombëtare, por nuk janë pjesë e pushtetit formal shtetëror. Ata veprojnë në mënyrë të pavarur dhe ndikojnë në proceset politike, ekonomike dhe sociale në nivel kombëtar dhe global.

(c) operacionet që synojnë grupet (etnike/identiteti, rinia, diaspora) me qëllim thellimin e ndarjeve; dhe

(d) operacionet hibride që kombinojnë manipulimin e informacionit me instrumente të tjera të tilla si aktivitetet kibernetike ose presionet diplomatike), ku NHMI-ja funksionon si pjesë integrale e një strategjie më të gjerë hibride (NATO, 2024).

Kjo kornizë në dokument shërben për të kuptuar se si shfaqen kërcënimet në hapësirën mediatike dhe për të formuar politika që zvogëlojnë ndikimin e tyre, pa kompromentuar lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatik dhe karakterin demokratik të debatit publik.

1.1. Matrica e ekspozimit të NHMI-së: korniza për hartëzimin e kanaleve

Raporti i tretë i Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm mbi kërcënimet nga NHMI-ja prezanton një mjet analitik - Matrica e Ekspozimit të NHMI-së (*FIMI Exposure Matrix*, për klasifikimin e kanaleve informative sipas shkallës dhe natyrës së lidhjes së tyre me aktorët e huaj kërcënues dhe rrjetet e ndikimit. Vlera e Matricës qëndron në faktin se ndihmon të kuptohet "arkitektura" e operacioneve të NHMI-së: përveç shtresës së dukshme (kanale zyrtare dhe publikisht të lidhura), ajo hartëzon edhe infrastrukturën e fshehur që mundëson infiltrimin në audiencat lokale dhe amplifikimin e narrativave manipulative përmes rrjeteve të kanaleve (EuvsDisinfo, 2025).

Matrica mbulon katër kategori kanalesh:

1. **Kanalet zyrtare shtetërore (Kategoria 1)** – profilet zyrtare dhe faqet e internetit të institucioneve shtetërore, ministrive, ambasadave dhe kanaleve të tjera zyrtare të komunikimit shtetëror.
2. **Media të kontrolluara nga shteti (Kategoria 2)** – media që formalisht kanë personin e tyre juridik, por financohen, menaxhohen ose kontrollohen në mënyrë editoriale nga shteti.
3. **Kanalet e lidhura me shtetin (Kategoria 3)** – kanale/media/profile zyrtarisht të pavarura me lidhje strukturore me shtetin ose aktorët e lidhur me shtetin (pronësia, financimi, koordinimi, modelet e përsëritura të propagandës).
4. **Kanale të harmonizuara me shtetin (Kategoria 4)** – burime që nuk mund t'i referohen zyrtarisht një aktori shtetëror, por tregojnë harmonizim sistematik dhe karakteristika të ngjashme të sjelljes, duke luajtur një rol të rëndësishëm në aktivitetet e NHMI-së.

Çdo kategori njihet përmes një kombinimi të treguesve teknikë dhe sjelljesorë, si lidhja ose prezantimi i deklaruar publikisht, gjurmët financiare dhe burimet e fi-

nancimit, infrastruktura e përbashkët, si dhe praktikat e amplifikimit (p.sh. ripublikim identik i përmbajtjeve, përkthime të automatizuara, ripublikime masive, mesazhe të koordinuara, profile joautentike etj.).

Në këtë dokument, Matrica e ekspozimit ndaj NHMI-së përdoret si një kornizë për hartimin e kanaleve dhe mekanizmave të ndikimit të ndikimeve informative. Qëllimi nuk është të "gjuhet" pas postimeve individuale problematike, por të kuptohet se si krijohet dhe amplifikohet ndikimi manipulativ, përkatësisht cilat kanale e prodhojnë atë, cilat e transmetojnë, si "derdhet" ndërmjet platformave dhe mediave dhe ku fiton dukshmëri lokale dhe legjitimitet. Kjo qasje është veçanërisht e dobishme sepse NHMI pothuajse kurrë nuk funksionon si një incident i izoluar, por ndërton një efekt gradual përmes kanaleve, ndërmjetësve dhe formateve të ndryshme.

Praktikisht, Matrica në këtë dokument shërben për katër detyra:

- Së pari, të bëhet një pasqyrë e llojeve të kanaleve të rëndësishme për rreziqet e NHMI-së në Maqedoninë e Veriut;
- Së dyti, të krahasohet kjo "hartë e kanaleve" me rregullat dhe mekanizmat ekzistues (ligje, instrumente rregullatore dhe vetërregulluese) dhe të identifikohen "pikat e verbra" sistemike;
- Së treti, të vlerësohet nëse institucionet dhe sektori kanë një shpërndarje të qartë të rolave dhe koordinim, veçanërisht për kanalet ku ndikimi është i tërthortë; dhe
- Së katërti, të formulohen masa që janë të qarta dhe proporcionale: standarde më të larta për transparencë dhe llogaridhënie aty ku është e justifikuar, dhe mjete preventive dhe afatgjata aty ku rreziku është i tërthortë (edukim mediatik, mbështetje e mediave të pavarura, standarde profesionale). Në të gjitha rastet, kriteri është pajtueshmëria me standardet evropiane dhe balancimi me lirinë e shprehjes dhe pluralizmin mediatik.

Është e rëndësishme të theksohet se aplikimi i Matricës këtu nuk do të thotë "etiketim" i mediave specifike vendase. Përdoret për të kuptuar më mirë pikat e rrezikut në sistem dhe për zhvillimin e rekomandimeve që fuqizojnë qëndrueshmërinë, pa logjikë ndëshkuese dhe pa kufizuar debatin publik legjitim.

2.

Konteksti evropian rregullator dhe strategjik për nhmi-në në media dhe ekosistemin digjital

Shërbimi Evropian për Punë të Jashtme *(EEAS)* e përcakton NHMI-në si një model kryesisht të paligjshëm të sjelljes, i cili megjithatë mund të ketë efekte të rëndësishme negative mbi vlerat, procedurat demokratike dhe proceset politike. Në fokus janë ekzistenca e një qëllimi të qartë, koordinimi, karakteri manipulues dhe përdorimi i ndërmjetësve dhe rrjeteve, jo vetëm saktësia/pasaktësia e pretendimeve individuale.

Kjo logjikë mbështetet nga prova empirike: raporti i dytë i *EEAS* bazohet në 750 incidente të hetuara të SMMI-së në periudhën 1 dhjetor 2022 - 30 nëntor 2023, i cili konfirmon nevojën për analiza që njohin "modelet" dhe sjelljet e përsëritura në vend të një rasti të izoluar (EEAS, 2024). Paralelisht, *EEAS* ka institucionalizuar kornizën përmes zhvillimit të një sërë veglash NHMI *(FIMI Toolbox)* dhe strukturave për zbulimin dhe ekspozimin sistematik të operacioneve, duke përfshirë Qendrën për Ndarjen dhe Analizën e Informacionit NHMI *(FIMI Information Sharing and Analysis Centre - FIMI-ISAC)* dhe ndërgjegjësimin e përbashkët të situatës në përputhje me logjikën më të gjerë të "mbrojtjes së rrjetit" evropian.

Raporti i tretë i *EEAS* shkon një hap më tej, me fokus në infrastrukturën digjitale (kanalet, domenet, rrjetet e faqeve/profileve, mënyrat e shpërndarjes) dhe paraqet Matricën e Ekspozimit të NHMI *(FIMI Exposure Matrix)* si një mjet për hartëzimin e arkitekturës dhe treguesve të funksionimit (EEAS, 2025). Kjo është veçanërisht e rëndësishme për këtë dokument politikash sepse e ridrejton debatin nga pyetja "cili publikim është i rremë" në pyetjen "cilat kanale dhe mekanizma krijojnë një efekt kumulativ në sferën publike dhe ku sistemi është i prekshëm".

2.1. Instrumentet rregullatore: llogaridhënia e platformës, transparenca dhe mbrojtja e pluralizmit mediatik

Bashkimi Evropian ndërton kuadrin rregullator me pikëpamjen se hapësira online nuk duhet të mbetet një hapësirë pa përgjegjësi kur bëhet fjalë për rreziqe sistematike për debatin publik dhe proceset demokratike. Në këtë drejtim, menaxhimi i rrezikut dhe transparenca forcohen, përmes një kombinimi të mekanizmave rregullatorë dhe bashkë-rregullues.

Një shembull praktik i kësaj logjike është transformimi i Kodit të Praktikës për Dezinformimin në Kodin e Sjelljes sipas Aktit të Shërbimeve Digjitale *(DSA)*, me Komisionin Evropian dhe Bordin Evropian për Shërbimet Digjitale e miratuan integrimin (shkurt 2025) si *njëpikë referimipër* demonstrimin e masave të reduktimit të rrezikut dhe transparencës (Komisioni Evropian, 2025).

Paralelisht, paketa e re rregullatore evropiane e lidh temën me pluralizmin dhe pavarësinë e medias dhe me ekonominë e ndikimit politik (transparenca e reklamave politike dhe kufizimi i praktikave të rrezikshme të synimit/amplifikimit). Këto instrumente janë të rëndësishme për NHMI-në, sepse ato nuk kufizohen në "përmbajtje të dëmshme", por trajtojnë infrastrukturën e ndikimit, përkatësisht, kush paguan, si synohet, si rritet shtrirja dhe cilat gjurmë transparente duhet të ekzistojnë (IviR, 2025).

Së fundi, Akti i BE-së për Inteligjencën Artificiale *(Akti AI)* (Bashkimi Evropian, 2024) prezanton standarde që bëhen drejtpërdrejt të rëndësishme për NHMI-në për shkak të rritjes së përdorimit të përmbajtjes sintetike, shënjestrimit të automatizuar dhe teknikave manipuluese të shkallëzueshme. Kështu, kuadri evropian e shtrin politikën nga "higjiena e informacionit" klasike në menaxhimin e rreziqeve teknologjike që prekin sferën publike.

2.2. Këshilli i Evropës dhe perspektiva e sigurisë: të drejtat e njeriut, dizajni dhe qëndrueshmëria

Përveç BE-së, Këshilli i Evropës zhvillon temën nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe kulturës demokratike. Drejtimi i Komitetit Drejtues për Mediat dhe Shoqërinë e Informacionit *(Steering Committee on Media and Information Society – CDMSI)* dhe Komitetit të Ekspertëve për Integritetin e Informacionit Online *(Committee of Experts on the Integrity of Online Information - MSI-INF)* strukturon në mënyrë të qartë luftën kundër (dez) informacionit në internet rreth tre shtyllave: kontrollit të fakteve, (2) zgjidhjeve në hartimin e platformës dhe (3) fuqizimit të përdoruesve, me një orientim të qartë drejt një qasjeje në përputhje me të drejtat e njeriut *(human rights compliant)*, përkatësisht masave që përqendrohen në proceset e renditjes/shpërndarjes dhe kushteve të informacionit sesa në një "gjykim të përmbajtjes" arbitrar (Këshilli i Evropës, 2023).

Nga pikëpamja e sigurisë, tema lidhet me rreziqet hibride dhe hapësirën kibernetike. Agjencia e BE-së për Sigurinë Kibernetike (ENISA) përgatit vlerësimet e kërcënimeve dhe tendencave, duke përfshirë kryqëzimin e lidhjeve midis rreziqeve kibernetike dhe NHMI-së në skenarë hibride (ENISA, 2022). Në këtë kontekst, Agjencia thekson se nevojitet një ndërgjegjësim i përbashkët i situatës dhe një përgjigje e koordinuar midis institucioneve, platformave dhe shoqërisë, pasi manipulimi i informacionit lidhet gjithnjë e më shumë me infrastrukturën teknologjike, automatizimin dhe abuzimin e shërbimeve digjitale.

Në këtë dokument, konteksti evropian shërben si një kornizë referimi për: (a) një dallim të qartë midis debatit të ligjshëm publik dhe manipulimit të koordinuar; (b) ndërtimin e masave proporcionale që mbrojnë lirinë e shprehjes; dhe (c) krijimin e një sistemi përgjegjësish - institucionale, mediatike dhe platforma - me fokus në parandalimin, transparencën dhe qëndrueshmërinë në vend të reagimeve ad-hoc.

2.3. Implikimet për Maqedoninë e Veriut: detyrimet dhe mundësitë në kontekstin e integrimit në BE

Megjithëse Maqedonia e Veriut nuk është ende anëtare e BE-së, si vend kandidat ajo ka një drejtim të qartë të përafrimit gradual me acquis dhe me standardet evropiane që rregullojnë sferën e medias dhe publikun digjital. Në kontekstin e NHMI-së, kjo do të thotë se përgatitja ose modifikimi i ligjeve dhe politikave përkatëse duhet të marrë parasysh qasjet evropiane që e trajtojnë problemin si një rrezik sistemik dhe jo si një çështje me "përmbajtje të diskutueshme" (EEAS, 2023).

Praktikisht, kjo hap tre prioritete:

1. përafrimin me parimet e Kornizës Evropiane për Llogaridhënien në Platformë, Transparencën dhe Menaxhimin e Rreziqeve, duke përfshirë marrjen e praktikave të mira nga mekanizmat korrigjues (siç është Kodi i Sjelljes për Dezinformim);
2. përfshirjen e logjikës së NHMI-së (treguesit, teknikat, praktikat e rrjetit) në strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit, për të shmangur një përgjigje të fragmentuar dhe ekskluzivisht reaktive;
3. nxitja e koordinimit midis institucioneve, rregullatorëve, sektorit të medias dhe shoqërisë civile, sepse NHMI-ja është një fenomen rrjeti që sipas përkufizimit kërkon një qasje më sektoriale.

Nga këndvështrimi i politikave publike, është thelbësore të shmangen dy ekstreme: injorimi i rreziqeve (lënia e hapësirës mediatike pa një përgjigje sistematike) dhe masat joproporcionale që mund të kufizojnë lirinë e shprehjes ose hapësirën e hapur për abuzim politik. Kornizat dhe standardet evropiane të Këshillit të Evropës ofrojnë një linjë praktike referimi për politikat që në të njëjtën kohë mbrojnë interesin publik, sigurinë dhe lirinë e medias.

3.

Perceptimet dhe nevojat që lidhen me nhm i-në në ekosistemin mediatik në kontekstin kombëtar

Në Maqedoninë e Veriut, ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet nuk rregullohen si fushë e veçantë politike. Në vend të kësaj, aspektet përkatëse përfshihen tërthorazi në ligje, strategji dhe mandate të shumta institucionale që rregullojnë sistemin e medias, proceset zgjedhore, mjedisin digjital dhe sigurinë kombëtare. Kjo qasje normative e shpërndarë lejon adresimin e pjesshëm të simptomave individuale, por jo menaxhimin sistematik të rrezikut.

Shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë kanë një rol të rëndësishëm dhe të njohur në forcimin e rezistencës ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe manipulimit të informacionit, veçanërisht në tre fusha të ndërlidhura: (1) hulumtimi dhe dokumentimi i tendencave dhe praktikave të ndikimit informativ, (2) ngritja e kapaciteteve në komunitetin mediatik dhe publikun e gjerë, dhe (3) mbështetja e mediave të pavarura dhe avokimi për zgjidhje më të mira rregullatore dhe institucionale. Në shumë raste, janë pikërisht organizatat qytetare dhe iniciativat hulumtuese që identifikojnë të parat dobësitë strukturore dhe fushatat e koordinuara, para se ato të përpunohen sistematikisht në analiza institucionale zyrtare.

Megjithatë, kjo shtyllë e rezistencës ka edhe kufizime që lidhen drejtpërdrejt me logjikën dhe dinamikën e NHMI-së.

Së pari, **organizatat e shoqërisë civile shpesh bëhen objektiva të fushatave diskredituese dhe etiketimit si "agjentë të huaj" ose "mercenarë"**, të cilat funksionalisht përshtaten me strategjitë që synojnë dobësimin e besimit në mekanizmat korrigjues të demokracisë dhe burimet e pavarura të verifikimit.

Së dyti, **logjika dominuese e projektit dhe varësia nga ciklet e donatorëve** e bëjnë të vështirë qëndrueshmërinë e ekspertizës dhe vazhdimësinë e aktiviteteve, megjithëse vazhdimësia është një parakusht kryesor për monitorimin sistematik të tendencave, paralajmërimin e hershëm dhe ndërtimin e kujtesës institucionale.

Së treti, **mungon një platformë formale dhe e qëndrueshme e koordinimit** që do të mundësonte shkëmbim të rregullt dhe të strukturuar të informacionit, treguesve dhe analizave mes institucioneve shtetërore, rregullatorëve, organizatave mediatike, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, si dhe protokolle të dakorduara për veprim të përbashkët gjatë periudhave të ndjeshme.

Në mungesë të një platforme të tillë, kontributi i shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë mbetet i rëndësishëm, por jo i integruar sa duhet në arkitekturën më të gjerë kombëtare si përgjigje ndaj NHMI-së. Kjo kufizon mundësinë për të njohur në kohë rreziqet sistemike dhe për një përgjigje të koordinuar, proporcionale dhe të mbrojtshme në mënyrë demokratike, gjë që thekson më tej nevojën për mekanizma më të qartë për bashkëpunim institucional, të cilat trajtohen në kapitullin e ardhshëm.

5.4. Boshllëqet kryesore përmes prizmit të Matricës së ekspozimit ndaj NHMI-së

Kur mekanizmat ekzistues shqyrtohen përmes kategorive të Matricës së ekspozimit ndaj NHMI-së, bëhen të qarta boshllëqet që janë më kritike pikërisht atje ku NHMI zakonisht fiton "mbështetje", përkatësisht në kanalet ndërmjetësuese dhe të harmonizuara shtetërore (kategoritë 3 dhe 4).

Së pari, në kontekstin kombëtar, **transparenca e pronësisë dhe financimit në një pjesë të tregut të mediave online mbetet e kufizuar dhe kjo është veçanërisht e shprehur në fushatën zgjedhore** në të cilën Kodi zgjedhor parashikon një shumë të konsiderueshme për një program politik të paguar dhe në ato media që kanë origjinë të dyshimtë. Edhe pse ekzistojnë iniciativa dhe diskutime publike për rritjen e dukshmërisë dhe llogaridhënies së mediave online, përfshirë edhe përmes rolit të mundshëm të rregullatorit, ende mungon një mekanizëm sistemik që të sigurojë një pamje të qëndrueshme, të verifikueshme dhe të krahasueshme të strukturave të pronësisë dhe rrjedhave financiare. **Kjo është direkt e rëndësishme për kanalet e lidhura me shtetin, përkatësisht kanalet/mediat/profilet formalisht të pavarur me lidhje strukturore me shtetin (pronësi, financim, koordinim), ku jo-transparenca krijon hapësirë për ndikim pa llogaridhënie publike.**

Së dyti, shtetit ende **i mungojnë mjetet e zhvilluara mjaftueshëm për të ashtuquajturin "menaxhim të butë" me rreziqet që rrjedhin nga kanale të harmonizuara me shtetin, domethënë burime që nuk mund t'i referohen zyrtarisht një aktori shtetëror, por tregojnë harmonizim sistematik dhe karakteristika të ngjashme të sjelljes.** Në këtë zonë, masat represive shpesh janë ose joefektive ose kundër produktive. Prandaj, fokusi duhet të jetë në transparencën, llogaridhënien e platformës, edukimin mediatik dhe forcimin e gazetarisë cilësore, pra politikat që ndërtojnë qëndrueshmëri në vend të krijimit të linjave të reja të polarizimit.

Së treti, **nuk ka koordinim dhe shkëmbim të mjaftueshëm të informacionit midis institucioneve të sigurisë, rregullatorëve, organizatave të medias dhe shoqërisë civile** mbi tendencat, treguesit dhe narrativat e rrezikut. Kjo nuk është vetëm një çështje organizative, por një parakusht për paralajmërim të hershëm dhe për komunikim publik që do të parandalojë "boshllëqet" në të cilat manipulimi është ngulitur më lehtë.

Së katërti, **standardet evropiane, përfshirë Ligjin për shërbime digjitale (DSA), Ligjin Evropian për lirinë e mediave (EMFA) dhe Kodin e praktikës për dezinformata**, ende **nuk janë "përkthyer" sistematikisht në ligjet vendase për mediat**, pastaj në **politikat, procedurat kombëtare dhe pritjet e qarta ndaj aktorëve kryesorë,** veçanërisht në fushat e transparencës, vlerësimit të rrezikut sistemik, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes së pavarur.

Së pesti, **kapacitetet për monitorim dhe hulumtim të vazhdueshëm janë të kufizuara**. Megjithëse ka raporte individuale cilësore, ka mungesë të një sistemi kombëtar të qëndrueshëm që do të siguronte të dhëna të rregullta për tendencat, modelet dhe kanalet, gjë që është një parakusht për politika të bazuara në prova dhe jo në reagime.

Kjo analizë tregon se Maqedonia e Veriut ka elemente përkatëse (baza ligjore, strategji, vetë-rregullim aktiv dhe kapacitete qytetare), por që mungon "ngjitësi", përkatësisht një kornizë e unifikuar, role të qarta, protokolle koordinimi dhe monitorim të qëndrueshëm dhe kapacitete paralajmëruese të hershme.

Kapitulli tjetër, bazuar në këto boshllëqe, propozon opsione të politikave publike që janë proporcionale, të zbatueshme dhe në përputhje me të drejtat e njeriut dhe standardet evropiane.

6.

Përfundim dhe rekomandime për politikat publike

6.1. Përfundim

Ky dokument i politikave publike tregon se Maqedonia e Veriut është në fakt e ekspozuar ndaj rreziqeve nga NHMI, të cilat shfaqen përmes kanaleve dhe praktikave të ndryshme në hapësirën mediatike dhe digjitale vendore. Këto rreziqe nuk kufizohen te dezinformatat individuale, por kanë një efekt kumulativ mbi besimin, debatin demokratik dhe qëndrueshmërinë e institucioneve.

Dokumenti përdor Matricën e ekspozimit ndaj NHMI-së për të drejtuar analizën nga një qasje reaktive e "korrigjimit të përmbajtjeve" drejt një kuptimi sistemik të ekspozimit: cilat kanale janë më të cenueshme, ku përsëriten pikat e amplifikimit dhe cilat "pika të verbra" ekzistojnë në mekanizmat ekzistues. Në kontekst kombëtar, kjo është veçanërisht e rëndësishme për shkak të kombinimit të faktorëve që rrisin cenueshmërinë – polarizimi politik, qëndrueshmëria e kufizuar financiare e mediave, besimi i ulët në institucionet dhe edukimi i pamjaftueshëm mediatik dhe digjital.

Në nivel kombëtar, theksohen tre dobësi që zvogëlojnë drejtpërdrejt rezistencën ndaj NHMI-së. Së pari, fenomeni rrallë emërtohet dhe operacionalizohet qartë si një rrezik i veçantë në dokumentet strategjike dhe normative. Së dyti, reagimi institucional është i fragmentuar dhe shpesh ad-hok, pa një mekanizëm të qëndrueshëm për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit. Së treti, cenueshmëria e tregut të medias dhe mos transparenca në një pjesë të ekosistemit online lehtësojnë "legjitimimin lokal" dhe qarkullimin e narrativave manipuluese.

Në të njëjtën kohë, ka kapacitete që mund të shërbejnë si bazë për azhurnimin, përkatësisht sistemin vetë-rregullues, organizatat aktive të shoqërisë civile me ekspertizë dhe ndërgjegjësim institucional në rritje për rreziqet hibride.

Masat e propozuara në këtë dokument janë hartuar për të gjetur një ekuilibër midis dy objektivave po aq të rëndësishme:

(a) **mbrojtjen e proceseve demokratike dhe interesit publik** përmes integrimit më të qartë të NHMI-së në politikat përkatëse, koordinimit të përmirësuar dhe rritjes së transparencës në sektorin e medias; dhe

(b) **promovimin e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik** përmes përparësisë së arsimimit mediatik, vetë-rregullimit dhe mbështetjes së mediave të pavarura, në vend të masave të gjera represive që mund të jenë kundër produktive ose të ndjeshme ndaj abuzimit. Mesazhi kryesor është se rezistenca nuk ndërtohet duke kufizuar liritë, por duke forcuar cilësinë dhe besimin në sferën publike.

Që rekomandimet të kenë një ndikim real, zbatimi duhet të jetë politikisht i përgjegjshëm dhe institucionalisht i qëndrueshëm, me role dhe kompetenca të qarta, transparencë dhe mbikëqyrje, si dhe një proces gjithëpërfshirës në të cilin organizatat e medias, shoqëria civile dhe akademia janë partnerë realë. Për shkak të evolucionit të shpejtë të ekosistemit digjital, është gjithashtu i nevojshëm monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i masave.

6.2. Masat e propozuara për politika publike

Bazuar në llojet dhe praktikat e identifikuara të kërcënimeve (Kapitulli 4) dhe boshllëqet e identifikuara institucionale dhe sektoriale (Kapitulli 5), ky kapitull propozon masa me një qëllim të përbashkët, i cili është **rritja e rezistencës së Maqedonisë së Veriut ndaj ndërhyrjes së huaj dhe manipulimit të informacionit pa shkelur standardet demokratike, lirinë e shprehjes, liritë e medias dhe pluralizmin.** Masat grupohen sipas aktorëve kyç dhe, aty ku është e përshtatshme, lidhen me kategoritë e Matricës së ekspozimit ndaj NHMI-së, si mjet analitik për proporcionalitet – nga kanalet zyrtare institucionale, përmes mediave me rol publik dhe varësi të mundshme nga burimet publike, deri te ekosistemi më i gjerë online.

Për më tepër, nocioni **i NHMI-së duhet të përcaktohet më qartë dhe të përfshihet në politikat dhe rregulloret përkatëse** si një bazë e përbashkët për njohjen e rrezikut dhe reagimin e koordinuar. Paralelisht, nevojitet ngritja **sistematike e kapaciteteve të gazetarëve** (trajnime dhe ndërgjegjësim për zbulimin e fushatave të koordinuara, inkurajimin e tregimeve analitike dhe rrjetëzimin me qendrat kërkimore). Në mbështetje të këtyre masave, është e rëndësishme **të zhvillohen dhe centralizohen burimet dhe mjetet për gazetarët dhe institucionet** - një proces që tashmë ka filluar, por është ende në fillimet e tij në vendin tonë (ResPublica, 2025).

Institucione qeveritare dhe kanale zyrtare

Për të zvogëluar hapësirën për manipulime, kanalet zyrtare institucionale duhet të funksionojnë si burim i qëndrueshëm i informacionit të verifikueshëm, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore, tensioneve gjeopolitike dhe krizave të sigurisë, pra në momente kur NHMI-të më lehtë "zënë rrënjë". Kjo kërkon një zhvendosje nga reagimet ad-hoc në një sistem paralajmërimi të hershëm dhe komunikim të koordinuar publik.

- Qasja për parandalimin dhe ballafaqimin me **NHMI** duhet të **përfshihet në mënyrë të qartë në strategjitë dhe politikat përkatëse kombëtare** (siguria kombëtare, siguria kibernetike, komunikimi strategjik dhe komunikimet publike), me një përkufizim të harmonizuar të termit dhe rreziqe, objektiva dhe ndarje të kompetencave të përcaktuara qartë. Harmonizimi me qasjet evropiane (përfshirë kornizën e *EEAS* dhe metodologjitë e manipulimit të lidhura me zgjedhjet) është e rëndësishme si gjuhë e përbashkët dhe për krahasueshmëri, por jo si "marrje" mekanike e zgjidhjeve.
- Nevojitet një **strukturë e vogël, por funksionale e koordinimit** (njësi ose grup pune ndërministror) me mandat të qartë për të monitoruar trendet, për të vlerësuar rreziqet, për të rënë dakord për mesazhet institucionale dhe për të mbështetur mohimet e shpejta dhe të verifikueshme. Në këtë drejtim, një grup

koordinimi ndërinstitucional për trajtimin e NHMI-së u iniciua dhe u krijua në vitin 2025 (IKS, 2025). Struktura duhet të funksionojë në mënyrë transparente, me kufizime të qarta të rolit (pa "vlerësimin e së vërtetës" në debatin publik) dhe me respektimin e lirisë së shprehjes, në mënyrë që të perceptohet si një mekanizëm me interes publik dhe jo si një instrument politik.

- Shteti duhet të zhvillojë dhe testojë **procedurat standarde operacionale për incidentet informative** - kush reagon, brenda çfarë afati, në çfarë baze (prova/burime), përmes çfarë kanalesh dhe me çfarë rregullash për të qetësuar situatën dhe për të shmangur përshkallëzimin. Këto procedura duhet të shoqërohen me trajnime për zëdhënësit dhe zyrtarët për gjuhën që është e saktë, e verifikueshme dhe jo-polarizuese, veçanërisht kur qëllimi i manipulimit është paniku dhe konflikti.
- **Transparenca proaktive është e nevojshme**, përkatësisht informime tematike për fushat që shpesh janë objekt i manipulimeve (integrimi evropian, politika e jashtme, mbrojtja), qasja e përmirësuar e gazetarëve në informacionin zyrtar në kohë dhe zgjerimin e praktikave të të dhënave të hapura. Në këtë kontekst, nuk bëhet fjalë për një "luks" komunikimi, por për parandalim, sepse kur institucionet vonohen, boshllëkun e mbushin spekulimet dhe kornizat manipuluese.

Shërbimi publik dhe mediat me rreziqe strukturore që lidhen me burimet dhe lidhjet publike

Tek mediat me rol publik ose me varësi të mundshme nga burimet publike, rreziku nga NHMI zakonisht nuk shfaqet si "propagandë e drejtpërdrejtë", por si marrje jo kritike, legjitimim ose amplifikim i kornizave të të tjerëve, veçanërisht në kontekste krize dhe gjeopolitike. Prandaj, masat këtu kanë për qëllim mbrojtjen e autonomisë editoriale, transparencës dhe standardeve profesionale që zvogëlojnë cenueshmërinë.

- Nevojitet forcim sistematik shtesë **i shërbimit publik (Radio Televizioni i Maqedonisë) përmes garancive reale të pavarësisë** me procedura transparente dhe de-partizane për përzgjedhjen e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse, kritere të qarta për integritetin dhe llogaridhënien publike të menaxhmentit. Një opsion për këtë masë është ndarja e RTM-së nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LShMAAV) dhe përgatitja e një ligji të veçantë për shërbimin publik. Kjo është në përputhje me parimet e Këshillit të Evropës dhe logjikën *EMFA-së* për t'u mbrojtur nga ndikimi politik dhe për të forcuar interesin publik.
- **Shërbimi publik duhet të përfshijë çështjet e NHMI-së në dokumentet e veta strategjike dhe mekanizmat e brendshëm**, përkatësisht në protokollet për verifikimin dhe kontekstualizimin e burimeve të huaja, rregulla të qarta për mbulimin e temave gjeopolitike në periudha të ndjeshme dhe përmirësimin e standardeve të brendshme etike për të parandaluar "ritransmetimin" manipulues.

- Në segmentin e **kanaleve me rreziqe strukturore** (pronësia jo transparente, varësia nga fondet publike, flukset e pakontrolluara financiare), përgjigja kryesore është **transparenca**, përkatësisht informacioni publik, lehtësisht i kërkueshëm mbi **pronësinë dhe financimin**, si dhe **rregullat e qarta mbi fondet publike** (përfshirë reklamat shtetërore) me kritere, procedura, llogaridhënie dhe mbikëqyrje të pavarur të qartë. Këto masa reduktojnë "zonën gri" në të cilën ndikimi mund të ushtrohet pa shikueshmëri publike.
- Roli i **rregullatorit duhet të forcohet** jo në drejtim të sanksionimit të përmbajtjes politikisht të parëndësishme, por **si një burim publik për monitorimin e tendencave**, me raporte periodike me tregues të praktikave të përsëritura manipuluese dhe strukturave të ekspozimit në transmetim, të cilat do të shërbejnë si bazë për politika dhe korrigjime profesionale.
- Në lidhje me **kanalet e huaja propagandistike të kontrolluara nga shteti, çdo masë që ndikon në shpërndarje duhet të bazohet në mënyrë rigoroze në ligjshmëri dhe proporcionalitet,** me garanci të qarta (baza ligjore, vendimi transparent, mundësi për mbrojtje juridike) dhe, kur është e zbatueshme, në përputhje me masat kufizuese evropiane, për të shmangur kundër-efektet dhe rrezikun e abuzimit.

Transparenca, edukimi mediatik dhe mbështetja e mediave të pavarura

Duke pasur parasysh se kanalet e harmonizuara me shtetin, domethënë burimet që nuk mund t'i referohen zyrtarisht një aktori shtetëror, por tregojnë pajtueshmëri sistematike dhe karakteristika të ngjashme të sjelljes, mbulojnë zonën në të cilën kornizat manipuluese paraqiten më shpesh si ndjenjë publike "organike", përgjigjja kryesore nuk mund të jetë represive. Masat më efektive këtu janë qytetarët e informuar në mënyrë kritike, mediat profesionale dhe mekanizmat korrigjues të qëndrueshëm.

- **Edukimi mediatik dhe informativ duhet të përcaktohet si një politikë publike sistematike**, jo si një aktivitet i projektit. Ai duhet të integrohet si një kompetencë horizontale në arsim (me rezultate dhe materiale) dhe të plotësohet me programe për të rriturit përmes institucioneve lokale dhe fushatave publike. Ky është themeli i qëndrueshmërisë, sepse zvogëlon cenueshmërinë ndaj manipulimeve emocionale dhe të identitetit.
- Nevojiten mekanizma transparentë për të **mbështetur gazetarinë me interes publik, veçanërisht gazetarinë hulumtuese dhe analitikën e rrjetit/narrativës**. Kushti kryesor është që fondet të hartohen me mbrojtje të fortë nga ndikimi politik (thirrjet publike, komisionet e pavarura, llogaridhënia), në mënyrë që të mos shndërrohen në një instrument kontrolli. Përveç kësaj, nevojiten **trajnime dhe**

mentorime të specializuara për gazetarët për raportimin dhe hulumtimin e NHMI-së, zhvillimin dhe përdorimin e mjeteve ekzistuese për verifikim dhe analizë, si dhe bashkëpunimin me qendrat analitike dhe shoqatat ndërkombëtare gazetareske - aktivitete që fillojnë në vendin tonë, por që duhet të bëhen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme (IKS, 2025).

- **Vetë-rregullimi** (Këshilli i Etikës, Këshilli i Nderit, si dhe shoqatat e gazetarëve dhe mediave) **duhet të forcohet si një burim publik**, përmes mbështetjes së qëndrueshme, dukshmërisë më të madhe dhe një roli të qartë në debatet profesionale mbi standardet, përfshirë standardet për përdorimin e burimeve të huaja, pretendimeve të paprovuara dhe narrativave të ndjeshme gjeopolitike. Vetë-rregullimi ofron korrigjim të ligjshëm pa presionin e shtetit.
- **Transparenca në komunikimin dhe reklamimin politik, veçanërisht në internet, duhet të rritet** përmes markimit të qartë tëreklamave politike dhe përmbajtjes së sponsorizuar, komisionerit dhe informacionit të financimit, dhe mbikëqyrjes më të fortë në periudhat zgjedhore në koordinim me KSHZ-në, rregullatorin dhe vëzhguesit e qytetarëve. Kjo zvogëlon mundësinë e "maskimit" të NHMI-së si një fushatë e brendshme legjitime. Për më tepër, shënimi i teksteve, fotografive dhe videove që krijohen nga institucionet publike, dhe më pas dërgohen në media në formën e njoftimeve ose informacioneve për publikun, gjithashtu duhet të përmbajë një shënim të qartë me një logo nga institucioni specifik. Në këtë mënyrë, audienca do të bëjë më qartë dallimin midis materialeve qeveritare të komunikimit dhe përmbajtjes autentike të medias.

Koordinimi multisektorial: lidhja e sektorëve të sigurisë, medias dhe shoqërisë civile

Një nga gjetjet më të qëndrueshme është se Maqedonia e Veriut ka kapacitete individuale, por i mungon një platformë e qëndrueshme për koordinim. Prandaj rekomandohet:

- **Krijimi i një platforme/këshilli kombëtar për NHMI-në dhe kërcënimet hibride që do të lidhë institucionet përkatëse, AShMAA-në, KSHZ-në, organizatat mediatike, organet vetë-rregulluese, iniciativat e kontrollit të fakteve dhe qendrat kërkimore.** Ky organ nuk duhet të jetë i ashtuquajturi "komisioni i së vërtetës", por një mekanizëm praktik për shkëmbimin e treguesve, harmonizimin e protokolleve dhe përmirësimin e komunikimit publik në situata krize.
- Në këtë kuadër, rekomandohen **trajnime të përbashkëta dhe ushtrime simulimi** për skenarët e manipulimit në lidhje me zgjedhjet, si dhe **zhvillimin e procedurave standarde operacionale** që përcaktojnë hapat për monitorimin, verifikimin, reagimin institucional, informacionin për mediat dhe bashkëpunimin me aktorët korrigjues (vetë-rregullimi në media).

- Masat duhet të mbështeten në **bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar** (metodologjitë dhe praktikat e mira të *EEAS*, Këshillit të Evropës, Qendrës Evropiane të Ekselencës për Ballafaqimin me Kërcënimet Hibride *(Hibrid CoE)* në Helsinki), pasi NHMI është si rregull një fenomen ndërkufitar dhe kërkon krahasueshmëri të të dhënave dhe mekanizmave të paralajmërimit të hershëm.

Platformat online, përmbajtja sintetike dhe integriteti zgjedhor (përparësi ndërsektoriale)

Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e ekspozimit ndaj ndërhyrjes së huaj dhe manipulimit të informacionit ndodh përmes platformave online dhe shpërndarjes algoritmike, është e nevojshme të **krijohet një "protokoll zgjedhor" i qartë kombëtar për sferën digjitale.** Qëllimi i një protokolli të tillë nuk është të kontrollojë përmbajtjen, por të forcojë transparencën, informimin në kohë dhe besimin në procesin zgjedhor.

Ky protokoll duhet të bazohet në koordinimin midis Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, rregullatorit, institucioneve përkatëse shtetërore dhe vëzhguesve të shoqërisë civile, me role dhe procedura të përcaktuara qartë në drejtim të transparencës së reklamave politike, identifikimit në kohë të rrjeteve të koordinuara joautentike dhe informimit publik në rastet e manipulimit sistematik. Është veçanërisht e rëndësishme që këto mekanizma të funksionojnë pa kufizuar fjalën e ligjshme politike dhe me respekt të plotë për lirinë e shprehjes.

Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmbajtjeve sintetike dhe të manipuluara (përfshirë materialet audio dhe video), të cilat paraqesin një rrezik në rritje për integritetin zgjedhor dhe besimin në institucione. Kjo pritet të përbëjë një problem në rritje në të ardhmen duke pasur parasysh disponueshmërinë e aplikacioneve të bazuara në IA dhe potencialin për të gjeneruar përmbajtje që më pas mund të keqpërdoren. Nevojiten rregulla të qarta për etiketimin e përmbajtjes së tillë, udhëzime publike për njohjen e tyre dhe procedura të përcaktuara për sqarime të shpejta dhe të verifikueshme nga institucionet, veçanërisht në rastet kur një burim "zyrtar" imitohet ose keqinterpretohet. Kjo qasje ka një funksion parandalues dhe zvogëlon mundësinë e zgjerimit të manipulimit para se të ekspozohet publikisht.

Lista e shkurtesave

ASHMAA - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele
AKE - Agjencia për Komunikimeve Elektronike
BZHA - Byroja për Zhvillim dhe Arsim
OSHC - Organizata të shoqërisë civile
KSHZ - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
LShMAA – Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele
SHGM - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
TIK - Teknologjitë e Informacionit dhe komunikimeve
ISK - Instituti për Studime të Komunikimit
IMM- Instituti Maqedonas për Media
EMI - Edukimi mediatik dhe informativ
MIS - Sistemet e Rrjetit dhe Informacionit (në kontekstin e Ligjit për sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit)
MM - Ministria e Mbrojtjes
MPJ - Ministria e Punëve të Jashtme
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
RTVM - Radio Televizioni i Maqedonisë
KEM - Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
NHMI - Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet (ekuivalenti i FIMI)
BE - Bashkimi Evropian
AI Act - Artificial Intelligence Act (Ligji i BE-së për inteligjencën artificiale)
CoE - Council of Europe (Këshilli i Evropës)
CDMSI - Steering Committee on Media and Information Society (Council of Europe)
MSI-INF - Committee of Experts on the Information Environment (Council of Europe)
DSA - Digital Services Act (Akti i Shërbimeve Digjitale)
EEAS - European External Action Service (Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm)
EMFA - European Media Freedom Act (Akti Evropian për Lirinë e Mediave)
ENISA - European Union Agency for Cybersecurity (Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike)
EUvsDisinfo - EEAS/Platforma e BE-së për Monitorimin dhe Ekspozimin e Dezinformatave
FIMI - Foreign Information Manipulation and Interference
FIMI-ISAC - (FIMI) Information Sharing and Analysis Center
International IDEA - International Institute for Democracy and Electoral Assistance
NATO - North Atlantic Treaty Organization
OSCE - Organization for Security and Co-operation in Europe
OSINT - procesi i mbledhjes dhe analizimit të informacionit të disponueshëm për publikun për të vlerësuar kërcënimet, për të marrë vendime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve specifike.
UNDP - United Nations Development Programme

Literatura e përdorur:

1. Association of Journalists of Macedonia (AJM) и SafeJournalists Network (2025) North Macedonia: Indicators on the Level of Media Freedom and Journalists' Safety Index 2024. Shkup: SHGM/SafeJournalists Network.
2. Council of Europe (2023) Guidance Note on countering the spread of online mis- and disinformation through fact-checking and platform design solutions in a human rights compliant manner (miratuar nga CDMSI, 15.12.2023). Strasbourg: Council of Europe.
3. Council of Europe (2021) Information Disorder: Toward an Interdisciplinary Framework for Research and Policy Making. Strasbourg: Council of Europe.
4. Dellov, V. (2025) "IKS inicion koordinimin institucional në trajtimin e ndikimit të huaj dhe dezinformatave". Instituti për Studime të Komunikimit, 16.07.2025.
5. European Commission (2025) „Commission endorses the integration of the voluntary Code of Practice on Disinformation into the Digital Services Act" (Press release, 12.02.2025). Brussels: European Commission.
6. European Commission (2025) North Macedonia Report 2025. Brussels: European Commission.
7. European Commission (2025) 'The Digital Services Act'. Shaping Europe's digital future (policy page). Brussels: European Commission.
8. European External Action Service (EEAS) (2025) „Inside the infrastructure of Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI) operations". Brussels: EEAS.
9. European External Action Service (EEAS) (2025) 3rd EEAS Report on Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI) Threats: Exposing the architecture of FIMI operations (March 2025). Brussels: EEAS.
10. European Commission (2024) Commission Guidelines for providers of Very Large Online Platforms and of Very Large Online Search Engines on the mitigation of systemic risks for electoral processes, pursuant to Article 35(3) of Regulation (EU) 2022/2065 (OJ C 2024/3014, 08.02.2024). Brussels: European Commission.
11. European Union Agency for Cybersecurity (ENISA) (2022) Foreign Information Manipulation and Interference and Cybersecurity: Building a common situational awareness. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
12. European External Action Service (EEAS) (2022) A Framework for a Joint EU Response to Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI). Brussels: EEAS.
13. European External Action Service (EEAS) (2023) Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI): A Framework for Analysis. Brussels: EEAS.

14. European External Action Service (EEAS) (2023) 1st EEAS Report on Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI) Threats: Towards a Framework for Networked Defense (February 2023). Brussels: EEAS.
15. European External Action Service (EEAS) (2024) Second EEAS Report on Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI) Threats (January 2024). Brussels: EEAS.
16. EUvsDisinfo (2025a) „Behind the curtain: a novel analytical approach to FIMI exposure". EUvsDisinfo, 19.03.2025.
17. EUvsDisinfo (2025b) 'Enter the galaxy: a network analysis of influence operations'. EUvsDisinfo, 09.04.2025.
18. European Union (2024) Regulation (EU) 2024/1083 (European Media Freedom Act). Official Journal of the European Union.
19. European Union (2022) Regulation (EU) 2022/2065 (Digital Services Act). Official Journal of the European Union.
20. European Union (2024) Regulation (EU) 2024/1689 (Artificial Intelligence Act). Official Journal of the European Union.
21. International IDEA (2025) Enablers and Incentives of Election-Related Foreign Information Manipulation and Interference in North Macedonia. Stockholm: International IDEA.
22. IREX (2024) Vibrant Information Barometer (VIBE): North Macedonia 2024. Washington, DC: IREX.
23. IViR (2025) European regulatory frameworks on election disinformation. Amsterdam: Institute for Information Law (IViR).
24. Macedonian Institute for Media (2023) Deprived media market, low ethical standards and the need for effective legislation: The future of media in North Macedonia. Skopje: MIM.
25. Macedonian Institute for Media (2021) Regulatory and self-regulatory framework against hate speech and disinformation in North Macedonia. Skopje: MIM.
26. Metamorphosis Foundation (2024) Disinformation and Civil Society Mapping Report: Western Balkans Region. Shkup: Fondacioni Metamorfozis.
27. NATO (2024) „Countering hybrid threats". NATO (web resource).
28. NATO StratCom Centre of Excellence (2020) Risks and Vulnerabilities in the Western Balkans. Riga: NATO StratCom COE.
29. ResPublica (2025) Sistemi Kombëtar i Rezistencës ndaj NHMI: Përmbledhje. Shkup: ResPublica.
30. ResPublica (2025) "Selmani: Gjashtë veta "mbrojnë" 150 institucione nga sulmet kibernetike". ResPublica (intervistë), 21.08.2025.
31. ResPublica (2025) "Trajanov: Maqedonia është e ekspozuar ndaj përpjekjeve për të ndikuar në situatat e brendshme". ResPublica (intervistë), 29.07.2025.

32. ResPublica (n.d.) "Mjete për përballjen me ndërhyrjen e huaj dhe manipulimin e informacioneve". ResPublica.

33. South East European Network for Media Professionalization (SEENPM) dhe OurMedia (2024) Trust in media and vulnerability to disinformation in South East Europe – Country findings for North Macedonia. Ljubljana: SEENPM/ OurMedia.

34. Trojachanec, M. dhe Rizaov, G. (2024) Stability Under Threat: FIMI in North Macedonia (September 2024). Shkup: Fondacioni Metamorfozis.

35. YouthWiki (European Commission/EACEA) (2025) „6.8 Media literacy and safe use of new media – Republic of North Macedonia". YouthWiki.

36. Byroja për Zhvillimin e Arsimit (2023) Korniza për edukim mediatik në arsimin fillor. Shkup: Byroja për Zhvillimin e Arsimit.

37. Blejer - Simon, K. (2025) Dokument për Politika Publike: Adresimi i ndërhyrjes së huaj dhe manipulimi i informacionit në kontekstin e rregulloreve Evropiane Shkup: Instituti për Studime të Komunikimit (ResPublica).

38. Grizhev, A. dhe Poposka, V. (2025) Përgjigja institucionale ndaj NHMI-së në Maqedoninë e Veriut: modelet dhe opsionet për politika. Shkup: Instituti për Studime të Komunikimit (ResPublica).

39. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (2024) Kodi zgjedhor - tekst i pastruar (prill 2024). Shkup: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

40. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (2025). Raporti vjetor për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve – 2024. Shkup: ShGM

41. Instituti për Studime të Komunikimit (2025) "Mbledhja e dytë e trupit koordinues për përballjen me ndërhyrjen e huaj dhe manipulimin e informacionet (NHMI)". Instituti për Studime të Komunikimit, 20.11.2025.

42. Instituti i Studimeve të Komunikimit (2025) "Trajnim për gazetarët për raportimin mbi ndërhyrjen e huaj dhe manipulimin e informacioneve (NHMI)". Instituti për Studime të Komunikimit, 25.08.2025.

43. Instituti për Studime të Komunikimit (2024) "Punëtori: Kompetencat për edukim mediatik". Instituti për Studime të Komunikimit, 05.11.2024.

44. Kramarska, S. (2025) "A do të ringjallen përsëri portalet nga jashtë në periudhën parazgjedhore?" SamoPrasaj, 16.09.2025.

45. Ministria e Transformimit Digjital (2025) Strategjia e Sigurisë Kibernetike 2025 - 2028. Shkup: Ministria e Transformimit Digjital.

46. Ministria e Transformimit Digjital (n.d.) Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shkup: Ministria e Transformimit Digjital.

47. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2021) Strategjia për mbrojtje kibernetike. Shkup: Ministria e Mbrojtjes.

48. Rrjeti për edukim mediatik (2023) "Rreth ne / Çfarë është Rrjeti për edukim mediatik?". Platformë online.

49. Fjalor për edukim mediatik (n.d.) "Rreth Fjalorit". Platformë online.
50. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2025) "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për media", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 87/2025 (29.04.2025).
51. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024) "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 193/2024 (18.09.2024).
52. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2023) Ligji për sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit. Shkup: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
53. Haxhi-Janev, M. dhe Stoilkovski, M. (2025) Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Analizë fillestare. Shkup: Instituti për Studime të Komunikimit (ResPublica).



Институт за комуникациски студии

www.iks.edu.mk
info@iks.edu.mk

British Embassy Skopje

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Monitorimi, zbulimi dhe ekspozimi i ndërhyrjeve të fshehta të huaja dhe manipulimit të informacionit", financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.